



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit  
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1022  
Dt 11.09.2015

Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 10.9.2015, mori:

**VENDIM**

**I**

- I. Anulohet pjesërisht konkursi për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Mitrovicës, të publikuar në shtypin ditor të datës 30.6.2015 dhe në ueb-faqen zyrtare të UMIB-it.
- II. Anulimi i konkursit do të bëhet për këto pozita:  
**Fakulteti Juridik:** Një asistent për grup lëndësh nga lëmi penal.  
**Fakulteti Ekonomik:** Një mësues për grup lëndësh nga lëmi i Ekonomiksit.  
Një asistent për grup lëndësh nga lëmi Financiar dhe i Kontabilitetit.  
**Fakulteti i Edukimit:** Një mësues për lëndët: Matematikë I, Matematikë II.  
Një mësues për grup lëndësh nga pedagogjia.  
Një mësues për grup lëndësh nga psikologjia.  
Një asistent për lëndët: Matematikë I, Matematikë II.  
Një asistent për grup lëndësh nga pedagogjia.
- III. Njoftimi për anulimin e pjesëshëm të konkursit për zgjedhjen e personelit akademik në njësitet akademike të UMIB-it i bashkëngjitet këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**II**

Senati i Universitetit të Mitrovicës, duke pasur parasysh kufijtë buxhetorë të përcaktuara me Qarkoren Buxhetore 2016/2, sipas të cilës nuk lejohet shtim i numrit të punëtorëve përtej kufizimeve buxhetore, si dhe në bazë të rekomandimit të Këshillit Drejtues për respektimin rigoroz të kufijve buxhetorë të përcaktuara me këtë qarkore, mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit  
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1029  
Dt 15.09.2015

Në bazë të nenit 50, pika 2, nenit 93, pika 2, nenit 94 dhe 95 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini, Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 10.9.2015, mori:

**VENDIM**

- I. Për emërimin e Komisionit të Studimeve të Senatit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Komisioni ka këtë përbërje:
  - Izet Zeqiri-kryetar;
  - Musa Rizaj- anëtar;
  - Islam Fejza-anëtar;
  - Aziz Behrami-anëtar;
  - Fatbardha Hoxha-anëtar;
  - Bashkim Preteni-anëtar;
  - Besart Hajrizi- anëtar,
  - Valon Sherifi-anëtar;
  - Lorita Bejtullahu-anëtar.
- III. Në bazë të Statutit të Përkohshëm, neni 94, Komisioni i studimeve është përgjegjës për: Hartimin e propozimeve të programeve të reja të studimeve; Përshtatjen dhe ndryshimin e programeve ekzistuese të studimit; Rishikimin e vazhdueshëm të teksteve universitare; Kërkesat për ndërrimin e programeve të studimeve nga studentët; Kërkesat për "studium irregulare" nga studentët; Përgatitjen e lëndës për ankesat e studentëve; Vlerësimin e studentëve.
- IV. Detyrat e Komisionit të studimeve janë: zhvillimi i koncepteve, vlerësimi dhe komentimi i kërkesave në mënyrë që të përgatis raporte për të cilat vendoset në Senat.
- V. Kohëzgjatja e mandatit të Komisionit të studimeve është në pajtim me rregulloret e Senatit për anëtar.
- VI. Vendimi hyn në fuqi nga dita e miratimit.

**Arsyetim**

Senati i Universitetit, duke pasur parasysh propozimet e njëjësive akademike dhe përfaqësimin e drejtë të secilës njësi akademike në këtë Komision, mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi. Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Anëtarëve të Komisionit,
3. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rëktor i UMIB-it